

VENDIM
Nr.315, datë 18.4.2020

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS PËR LOTIN 10, ME OBJEKT “BLERJE BARNA
BECLOMETHASONE + SALBUTAMOL 80 MCG+1600 MCG FLAKON”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 1, të kreut VII, të vendimit nr.203, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e kontratës për lotin 10, me objekt “Blerje barna Beclomethasone + Salbutamol 80 mcg+1600 mcg flakon”, me palë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe operatorin ekonomik “MEDICAMENTA”, sh.p.k., të zhvilluar me procedurën e drejtpërdrejtë, me objekt “Blerje barna kundër Coronavirus COVID–19, ndarë në 10 lote (një bar një lot)”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama